

VENDIM
Nr. 167, datë 1.3.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“PËR PLOTËSIMIN DHE DETAJIMIN E PROJEKTIT TË RIKUALIFIKIMIT URBAN
TË PAZARIT TË RI, MARKATËS SË MISHIT, FRUTA-PERIMEVE DHE SHESHIT
‘AVNI RUSTEMI’, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për plotësimin dhe detajimin e projektit të rikualifikimit urban të Pazarit të Ri, markatës së mishit, fruta-perimeve dhe sheshit “Avni Rustemi”, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 10 952 976 (dhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 10 952 976 (dhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga zbatimi i projektit "Për plotësimin dhe detajimin e projektit të rikualifikimit urban të Pazarit të Ri, Markatës së Mishit, Fruta-Perimeve dhe sheshit "Avni Rustemi"

Nr.	Emër mbiemër	Z. K.	Nr. Pas.	Sip. Përgj. Truall	Sip. Prekur Truall	Çmimi për m ² Truall	Sip. Përgj. Objekt	Sip. Prekur Objekt	Kosto për m ² Objekt	Vlera Truall+Objekt në lekë	Konfirmim ZVRPP, Tiranë	Shënime
1	Doloreza Izet Çiçaj	8150	2/103 - N1	20.8	20.8	66,969	20.8	20.8	16,071	1,727,232	Shkr. nr. prot.35394/1,prot.dt.06.12.2016	Njësi; Shënim në Seksionin E të kartelës së pasurisë: Bllokimi në favor të "Fondi Besa"
2	Merita Andrea Llupo	8150	2/103 - N2	38	38	66,969	38	38	16,071	3,155,520	Shkr. nr. prot.35394/1,prot.dt.06.12.2016	Njësi; Shënim në Seksionin E të kartelës së pasurisë: Bllokimi në favor të bankës "Emporiki"
3	Bajame Koçi	8150	2/103 - N3	25.7	25.7	66,969	25.7	25.7	16,071	2,134,128	Shkr. nr. prot.35394/1,prot.dt.06.12.2016	Njësi
4	Sana Hamit Velaj	8150	2/103 - N4	14.9	14.9	66,969	14.9	14.9	16,071	1,237,296	Shkr. nr. prot.35394/1,prot.dt.06.12.2016	Njësi
5	Emanuela Latif Kaimi	8150	2/103 - N6	32.5	32.5	66,969	32.5	32.5	16,071	2,698,800	Shkr. nr. prot.35394/1,prot.dt.06.12.2016	Njësi
				Shuma	131.90 m ²				131.90 m ²	10,952,976 lekë		

SHËNIM:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM 89, dt.03.02.2016.
2. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen nga ZVRPP, Tiranë, me shkresën nr. prot. 35394/1, dt.06.12.2016.
3. Sipërfaqja midis pasurive 2/103-N4 dhe 2/103-N6 është e konfirmuar pa informacion nga ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. prot. 35394/3, datë 25.01.2017, dhe për këtë arsye nuk është përfshirë në tabelën e llogaritjeve paraprake.